

LIGJ
Nr.10 404, datë 24.3.2011

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 8976, DATË 12.12.2002 “PËR
AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 21, pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Akciza e pagueshme për mallrat e akcizës, të përshkruara në shtojcën 1 të këtij ligji, llogaritet në përputhje me nenet 22 e 23 të këtij ligji, përveç mallrave të detyruara për t'u pajisur me pulla akcize ose me kod sigurie (më poshtë referuar “Pulla fiskale”), sipas neneve 24/1, 24/2 e 25 të tij.

3. Akciza e pagueshme për mallrat e akcizës që kërkojnë pulla fiskale, sipas neneve 24/1, 24/2 e 25 të këtij ligji, llogaritet në përputhje me nenet 26, 27 e 28 të tij.”.

Neni 2

Titulli i kreut IV ndryshohet si më poshtë:

“KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR MALLRA TË AKCIZËS QË KËRKOJNË PULLA FISKALE”.

Neni 3

Pas nenit 24 shtohen nenet 24/1 dhe 24/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 24/1

1. Pajisen me pullë akcize produktet e treguara në shtojcën 1 (Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë), pjesa II (birrë, verë, alkool dhe pije alkoolike) dhe pjesa III (duhani dhe nënproduktet e tij), të këtij ligji, duke përjashtuar birrën e prodhuar në vend, kur kërkohet pajisja me kodin e sigurisë, sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Kod i sigurisë do të thotë një shenjë direkte që aplikohet ekskluzivisht për produktet e birrës që prodhohen në Shqipëri nga prodhuesit në shkallë të madhe. Prodhuesit në shkallë të madhe përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Kodi i sigurisë trajtohet si dokument me vlerë dhe është monopol shteti.

3. Përgatitja dhe vendosja e kodit të sigurisë, kërkesa të tjera dhe procedurat e zbatueshme përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave. Rregullat e përcaktuara në pikën 2 të nenit 24 dhe në nenet 25, 26, 27, 28 e 29 të këtij ligji zbatohen me analogji dhe për kodin e

sigurisë.

Neni 24/2

1. Çmimi (duke përjashtuar TVSH-në dhe çdo taksë tjetër apo detyrim për pullat e aplikueshme, sipas ligjit në Shqipëri), për çdo pullë fiskale të prodhuar dhe të shpërndarë nga një koncesionar i autorizuar nga Republika e Shqipërisë për të lëshuar, shpërndarë dhe monitoruar pullat fiskale, përcaktohet në tabelën e treguar në shtojcën 2 të këtij ligji.

2. Të gjithë prodhuesit dhe importuesit, të cilëve, sipas ligjit, u kërkohet të aplikojnë pullën fiskale, i paguajnë koncesionarit çmimin e përcaktuar në shtojcën 2/1 të këtij ligji, në një llogari të specifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të udhëzimit të Ministrit të Financave.

3. Në rastin kur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve udhëzon koncesionarin të dërgojë pullat fiskale drejtpërdrejt te furnizuesi i huaj i mallrave, që janë subjekt i akcizës, në një adresë të treguar nga importuesi dhe të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, importuesit paguajnë, në një llogari të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, kostot e dërgesës dhe kostot e lidhura me të (duke përfshirë, por jo vetëm, shpenzimet e lidhura me trajtimin, sigurinë dhe sigurimet etj., por pa përfshirë taksat dhe detyrimet e importit). Taksat dhe detyrimet e importit paguhen nga furnizuesi i huaj.

4. Pagesa e pullave fiskale, si dhe shpenzimet përkatëse, siç përcaktohen në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, duhet të parapaguhet.

5. Pagesa e akcizës kryhet veçmas nga prodhuesit dhe importuesit.

6. Detyrimet që rrjedhin nga TVSH-ja apo taksa të tjera që janë të pagueshme, lidhur me pullat fiskale, të prodhuara dhe të shpërndara nga koncesionari, mbulohen nga prodhuesit apo importuesit që blejnë pullat fiskale.

7. Përgatitja dhe aplikimi i pullave fiskale dhe kërkesat e procedurat e tjera të zbatueshme përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 4

Në nenet 49 dhe 50, pas fjalëve “pullat e akcizës” ose “pullat” shtohen dhe fjalët “dhe kodet e sigurisë”.

Neni 5

Në nenin 55 pika 1 bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Pas shkronjës “g” shtohet shkronja “g/1” me këtë përmbajtje:

“g/1) për përcaktimin e modaliteteve për zbatimin e pullave fiskale, duke përfshirë, por jo vetëm, prodhimin, pagesën e taksës së akcizës dhe shpenzimet për prodhimin e zbatimin e pullave të akcizës dhe kodin e sigurisë, të personave të autorizuar për të prodhuar dhe zbatuar, dhe karakteristikat e të dhënave që përmbajnë në kodet e sigurisë së pullave të akcizës, si dhe dispozita të tjera, që lidhen me mallrat e akcizës, që duhet t’i aplikohen pullat e akcizës dhe kodet e sigurisë.”.

2. Shkronja “gj” ndryshohet si më poshtë:

“gj) për zbatimin e neneve 4, 5, 6, 10, 11, 12, 19, 22, 23, 24, 24/1, 24/2, 25, 26, 27, 28, 32, 36, 37, 38 dhe 39 të këtij ligji”.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.